



KODI I SJELLJES

INTEGRITETI DHE SJELLJA E TIKE

BUILDING TRUST



TABELA E PËRMBAJTJES

RREGULLAT E ETIKËS SË BIZNESIT	6
1. Respektoni ligjin	6
2. Jo ryshfetit, jo korrupsionit	6
3. Dhuratat, argëtimet dhe donacionet	7
4. Konkurrenca e ndershme	8
5. Shmangni konfliktin e interesit	9
6. Ndalimi i tregtimit bazuar në informacion të privilegjua	9
7. Ruani konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave	10
8. Mbroni asetet e Sika	11
9. Të drejtat e njeriut dhe standardet e punës: Kushtet e drejta të punës, pa ngacmime, pa diskriminim	11
10. Mbroni shëndetin, sigurinë dhe mjedisin	12
11. Partnerët e biznesit	13
12. Importi dhe eksporti	13
13. Pastrimi i parave	13
RREGULLAT E ZBATIMIT	14
14. Siguroni pajtueshmërinë me këtë Kod	14
15. Mbani transparencë të plotë dhe raportoni	14
16. Bëhuni shembull për të tjerët	15
17. Mos i anashkaloni këto rregulla	16
18. Pyetni nëse keni dyshime	16
19. Rregulli i përgjithshëm: Rregulli i gazetës	16
20. Zbatoni parimin “me dy palë sy”	16
21. Pyetje / komente	17

KODI I SJELLJES

Të dashur miq

Sika do të thotë **Të Ndërtosh Besim**. Sjellja etike dhe integriteti - ndërtojnë themelet e besimit.

Kolegët tanë, klientët, furnitorët dhe aksionarët mbështeten të gjithë në integritetin tonë. Sjellja juaj etike përfaqëson gurthemelin e reputacionit të shkëlqyer të Sika-s dhe suksesit afatgjatë të shoqërisë.

Kodi i Sjelljes synon të promovojë integritetin dhe sjelljen etike të Sika-s kudo që ajo operon nëpër botë. Ai përshkruan **Vlerat dhe Parimet** e Sika-s, të cilat janë themelet e kulturës sonë unike. Sika nuk pranon shkelje të ligjit dhe as të këtij Kodi, pasi ne mbajmë një qëndrim zero tolerancë ndaj sjelljeve joetike.

Me këtë Kod Sjelljeje të rishikuar, ne gjithashtu theksojmë angazhimin tonë të fuqishëm për zhvillimin e qëndrueshëm, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit.

Puna në përputhje me Kodin e Sjelljes është përgjegjësia juaj individuale, pavarësisht nga roli juaj, niveli hierarkik ose vendi i punës. Çfarëdo pozicioni të keni në Sika, ndiqni gjithmonë mesazhet dhe frymën e këtij Kodi. Bëhuni shembuj për të tjerët dhe frymëzoni edhe të tjerët të veprojnë njëjloj!

Faleminderit për angazhimin dhe kontributin tuaj të rëndësishëm në suksesin e Sika-s.



Thomas Hasler
CEO, Sika Group



Dr. Paul Hälgl
Kryetar i Bordit, Sika Group

Baar, prill 2022

INTEGRITETI DHE SJELLJA ETIKE

NE RESPEKTOJMË LIGJIN

NE NUK BËJMË KOMPROMIS KUNDËR
INTEGRITETIT

NE ZBATOJMË STANDARDE TË LARTA
ETIKE NË PUNËN TONË

NE SIGUROJMË PAJTUESHMËRINË ME TË
GJITHA KËTO PARIME



**PAJTUESHMËRIA ME KËTË KOD SJELLJEJE
ËSHTË PËRGJEGJËSIA PERSONALE E TË
GJITHË PERSONAVE QË PUNOJNË PËR SIK**



RREGULLAT E ETIKËS SË BIZNESIT

1. RESPEKTONI LIGJIN

- Zbatoni rreptësisht të gjitha ligjet dhe rregulloret që janë të zbatueshme për biznesin tonë.
- Zbatoni rreptësisht këtë Kod Sjelljeje dhe rregullore të tjera të brendshme, edhe nëse janë më të rrepta se ligjet në fuqi.

Pajtueshmëria e plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi përbën kornizën për të gjitha aktivitetet tona. Gjithashtu, ky Kod Sjelljeje përcakton rregulla që mund të jenë më të rrepta se ligjet në fuqi. Përveç kësaj, ekzistojnë rregullore të tjera të brendshme të cilat duhet të zbatohen.

2. JO RYSHFETIT, JO KORRUPSIONIT

- Mos ofroni asnjë favor (para në dorë, udhëtime, dhurata, etj.) me qëllimin për të ndikuar në vendimmarrjen e dikujt (p.sh., për të mbajtur ose për të fituar biznes) ose për të përfituar një avantazh të padrejtë (p.sh. një leje që Sika-s nuk i takon).
- Mos pranoni asnjë favor (para në dorë, udhëtime, dhurata, etj.) që ndikon në vendimmarrjen tuaj ose ju shtyn të jepni një avantazh të padrejtë (p.sh. një zbritje që partnerit të biznesit nuk i takon).

Sika është e angazhuar në luftën kundër çdo lloj korrupsioni. Sika i ndalon punonjësit e saj, agjentët dhe palët e tjera të treta që veprojnë në emër të saj të përfshihen në çfarëdo formë ryshfeti. Ryshfeti dhe korrupsioni mund të marrin forma të ndryshme. Mund të jetë para në dorë, por edhe ndonjë favor tjetër (udhëtime, dhurata të çdo lloji). Këto veprime gjithmonë synojnë të ndikojnë në vendimin e personit që i përfiton për të marrë një avantazh padrejtë nga personi ose subjekti që ofron favorin. Nuk ka rëndësi nëse ju e ofroni apo e përfitoni një favor të tillë. Nuk ka rëndësi se kush është pala tjetër (qeveria, shoqëria apo një person privat). Përveç dhuratave dhe argëtimit të zakonshme, të cilat nuk synojnë të ofrojnë një avantazh padrejtë (shihni më poshtë, 3.), nuk ka rëndësi sa i madh apo i vogël është favorin apo avantazhi. Sërish konsiderohet ryshfeti apo korrupsion, çka është rreptësisht e ndaluar.

3. DHURATAT, ARGËTIMET DHE DONACIONET

- Ofroni ose pranoni vetëm dhurata dhe argëtime që janë të ligjshme, të arsyeshme, në vlerë të moderuar dhe në përputhje me Politikën e Dhuratave dhe Argëtimit të kompanisë suaj lokale Sika.
- Kontributet e sponsorizimeve dhe të bamirësisë lejohen nëse janë në përputhje me Politikën e Dhuratave dhe Argëtimit të kompanisë suaj lokale Sika.
- Përdorimi i fondeve të Sika-s për të mbështetur politikanë, kandidatë për politikanë ose parti politike është i ndaluar. Donacionet për fushatat politike që mbështesin strategjinë ose aktivitetet e biznesit të Sika-s duhet të miratohen nga Drejtuesit e Grupit.

Në të gjitha vendet dhe tregjet, dhuratat dhe argëtimet e arsyeshme (dreka ose darka, aktivitete sportive ose kulturore, etj.) janë një praktikë e zakonshme biznesi. Ato bëhen ryshfet nëse synojnë të ndikojnë vendimin e personit që merr këto dhurata ose argëtime. Ftesat për udhëtime ose aktivitete shumëditore, si dhe dhuratat dhe argëtimet për zyrtarët publikë paraqesin rreziqe të veçanta. Të gjitha kompanitë - duhet të miratojnë një Politikë lokale të Dhuratave dhe Argëtimit, e cila duhet të përcaktojë nivelet e nevojshme të miratimit dhe të jetë në përputhje me politikën model të korporatës.



4. KONKURENCA E NDRSHME

- Veproni të orientuar drejt performancës dhe në mënyrë të drejtë në treg si përkundrejt klientëve ashtu edhe furnitorëve.
- Mos diskutoni, mos bëni marrëveshje dhe as mos bashkëpunoni në asnjë lloj forme me konkurrentët për strategjitë, çmimet, tregjet, klientët, produktet, prodhimin apo aspekte të tjera sensitive ndaj tregut.
- Mos bëni marrëveshje për çmimet e rishitjes me klientët e Sika.
- Kontrolloni paraprakisht çdo detyrim sensitiv (p.sh., të drejtat ekskluzive, shmangien e konkurrencës, sipërmarrjet e përbashkëta) me Departamentin Ligjor të Korporatës ose një këshilltar ligjor lokal.
- Mos abuzoni me një pozicion dominues në treg.

Pritshmëria jonë është respektimi i plotë i ligjeve në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës dhe ndalimin e përqëndrimeve. Kjo ka të bëjë veçanërisht me çdo lloj diskutimi ose marrëveshjeje me konkurrentët për çmimin ose aspekte të tjera sensitive ndaj tregut. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbledhjeve joformale, konferencave, shfaqjeve tregtare dhe takimeve të shoqatave tregtare ose diskutimeve ku mund të ketë gjasa të mundshme për blerje. Deri në masën që kontaktet me konkurrentët lejohen me ligj, ato duhet të menaxhohen nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe të dokumentohen siç duhet.



5. SHMANGNI KONFLIKTIN E INTERESIT

- Shmangni çdo situatë që mund të krijojë një konflikt interesi midis interesave tuaja personale ose familjare dhe interesave të Sika-s. Deklaroni plotësisht nëse identifikoni konflikte të tilla tek eprori juaj.
- Shmangni çdo aktivitet që konkurren me Sika.
- Mos përdorni një mundësi biznesi për Sika-n për përfitimin tuaj personal.

Vendimet e marra në emër të Sika-s nuk duhet të ndikohen nga interesa personale apo familjare. Nuk lejohet asnjë aktivitet konkurrues me Sika-n.

6. NDALIMI I TREGTIMIT BAZUAR NË INFORMACION TË PRIVILEGJUA

- Mos përdorni informacione konfidenciale, sensitive ndaj çmimit për të tregtuar aksione, opsione ose obligacione të Sika-s.
- Mos e ndani një informacion të tillë me palë të treta.
- Mos përdorni të dhëna konfidenciale, sensitive ndaj çmimit për të tregtuar aksione, opsione ose obligacione të partnerëve të biznesit të Sika-s ose për të ndarë një informacion të tillë me palë të treta.

Tregtimi i bazuar në informacionin e brendshëm do të thotë se keni përdorur informacion të privilegjuar për të arritur një fitim të padrejtë. Kjo është e paligjshme në Zvicër dhe në shumë vende të tjera. Tregtimi i bazuar në informacion të privilegjuar ka të bëjë kryesisht me tregtimin e aksioneve të Sika-s. Gjithashtu, nuk lejohet as përdorimi i njohurive të privilegjuara për të tregtuar aksione të partnerëve të biznesit të Sika-s.
Politika e Tregtisë së bazuar në informacion të privilegjuar dhe Transaksioneve të Menaxhimit (Sika Insider Trading and Management Transaction Policy) të Sika-s ofron udhëzime të mëtejshme, veçanërisht në lidhje me periudhat kur ndalohen transaksionet me titujt.

7. RUANI KONFIDENCIALITETIN, SIGURINË DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE

- Mbroni informacionin konfidencial, teknik dhe financiar të biznesit që lidhet me Sika-n.
- Brenda Sika-s, ndani informacione konfidenciale vetëm në bazë të nevojës për t'u ditur.
- Mos ndani informacione konfidenciale me asnjë palë të tretë, përveç nëse kërkohet për qëllime biznesi dhe vetëm pasi të keni nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti.
- Siguroni saktësinë dhe një nivel të përshtatshëm sigurie të informacionit konfidencial bazuar në **Politikat dhe direktivat e sigurisë së IT të Sika Group.**
- Mbroni informacionin konfidencial dhe të dhënat personale të palëve të treta dhe punonjësve tanë.
- Sigurohuni që të dhënat personale të mbledhura nga Sika të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe transparente.
- Veproni në përputhje me ligjet e zbatueshme në vend për mbrojtjen e të dhënave dhe respektoni parimet e politikave të brendshme të mbrojtjes së të dhënave të Sika-s.

Ruajtja e ekspertizës së Sika-s ka rëndësi të madhe. Ndërsa Sika nuk synon të pengojë rrjedhën e informacionit të kërkuar për biznesin, është tejet e rëndësishme që ekspertiza e Sika-s të mbrohet nga përdorimi i papërshtatshëm. Ne mbrojmë në mënyrë të barabartë informacionin konfidencial të palëve të treta. Sika është e përkushtuar të respektojë privatësinë dhe integritetin e të dhënave të të gjithë punonjësve dhe palëve të treta.



8. MBRONI ASETET E SIKA

- Përdorni me kujdes asetet e Sika-s (pajisjet, kompjuterët, automjete, etj.) dhe vetëm për qëllime biznesi, përveç nëse miratohet ndryshe nga eprori juaj.
- Mbrojeni ato nga çdo lloj keqpërdorimi (mashttrim, vjedhje, humbje).

9. TË DREJTAT E NJERIUT DHE STANDARDET E PUNËS: KUSHTET E DREJTA TË PUNËS, PA NGACMIME, PA DISKRIMINIM

- Veproni plotësisht në përputhje me ligjet e punës dhe të punësimit dhe politikat e brendshme të Sika-s që pasqyrojnë standardet ndërkombëtare të punës.
- Trajtoni vartësit dhe kolegët tuaj të punës në mënyrë të drejtë dhe me respekt.
- Angazhohuni në promovimin e diversitetit dhe një kulture gjithëpërfshirëse të bazuar në besim për të lehtësuar inovacionin, mendjegjerësi dhe mundësitë e barabarta.
- Mos i trajtoni të tjerët në mënyrë të padrejtë në bazë të racës, kombësisë, orientimit seksual, gjinisë, moshës, fesë etj., dhe as mos i ngacmoni, abuzoni, ofendoni, kërcënoni ose frikësoni verbalisht ose fizikisht të tjerët.
- Mos toleroni asnjë lloj sjelljeje abuzive apo diskriminim të punonjësve dhe raportoni shkeljet e vërejtura te menaxheri juaj ose te BNj.

Sika promovon një mjedis pune të larmishëm dhe gjithëpërfshirës, ku të gjithë punonjësit e trajtojnë njëri-tjetrin me drejtësi dhe respekt. Sika është e përkushtuar ndaj mundësive të barabarta dhe ndalon rreptësisht ngacmimet seksuale dhe çdo ngacmim tjetër në vendin e punës. Sika kërkon të sigurojë që sjellja e të gjithë punonjësve të jetë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut të miratuara ndërkombëtarisht, si dhe me standardet bazë të punës dhe ato sociale dhe mbështet dhjetë parimet e Traktatit Global të Kombeve të Bashkuara. Sika është angazhohet për shmangien e të gjitha formave të punës së të miturve dhe punës me forcë (duke përfshirë skllavërinë moderne dhe trafikimin e qenieve njerëzore), si brenda rrjetit të saj të zinxhirit të furnizimit, ashtu edhe për njohjen e lirisë së organizimit, marrëveshjeve kolektive dhe partneritetit social, kompensimit të drejtë dhe orarit të drejtë i punës.*

** Këto standarde përfshijnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Udhëzimet e OECD-së për Sipërmarrjet Shumëkombëshe dhe Deklaratën Trepalëshe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për Parimet në lidhje me Sipërmarrjet Shumëkombëshe dhe Politikën Sociale.*

10. MBRONI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

- Respektoni ligjet e mjedisit, të shëndetit dhe të sigurisë dhe udhëzimet e brendshme përkatëse.
- Promovoni një kulturë sigurie dhe mos bëni kurrë kompromis për sigurinë dhe mbrojtjen e të tjerëve.
- Promovoni përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe përfshihuni në praktika të qëndrueshme biznesi, duke minimizuar ndikimin në mjediset e Sika-s (ajri, mbetjet, uji, konsumi i energjisë dhe biodiversiteti), duke kontribuar në një ekonomi qarkulluese dhe duke i dhënë përparësi teknologjive miqësore ndaj mjedisit.
- Asnjëherë mos lejoni që përfitimet ekonomike të kenë përparësi mbi sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Siguria dhe mirëqenia e punonjësve për Sika-n është prioritet. Sika drejton një biznes të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në aspektin social. Sika mban përgjegjësi të veçantë për të vepruar në përputhje të plotë me ligjet për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin dhe kërkesat e brendshme, në interes të punonjësve tanë, klientëve dhe shoqërisë në tërësi, dhe për të ardhmen e planetit tonë.



11. PARTNERËT E BIZNESIT

- Sigurohuni që furnitorët, ofruesit e shërbimeve, agjentët dhe shpërndarësit të veprojnë në përputhje me këto rregulla.
- Zbatoni rregullat e klientëve veçanërisht në rastin e dhuratave dhe argëtimit, edhe nëse ato janë më të rrepta se ky Kod Sjelljeje dhe politika juaj lokale e dhuratave dhe argëtimit.

*Pritshmëritë e Sika-s janë që partnerët dhe furnitorët e saj të biznesit të veprojnë me integritet dhe të respektojnë të njëjtat rregulla të etikës së biznesit. Për të përmbushur këtë qëllim, furnitorëve të Sika-s u kërkohet t'i përmbahen **Kodit të Sjelljes së Furnitorit** (Sika Supplier Code of Conduct) të Sika-s. Sika mbështet furnitorët e saj me trajnime dhe monitoron nivelin e tyre të pajtueshmërisë përmes pyetësorëve dhe auditimeve.*

12. IMPORTI DHE EKSPORTI

- Pajtohuni me sanksionet e zbatueshme, si dhe rregulloren për mospërhapjen, rregulloret e kontrollit të import-eksportit dhe të materialeve të rrezikshme.
- Siguroni deklarata të sakta doganore dhe merrni të gjitha lejet e kërkuara doganore.

Sika është e përkushtuar të respektojë të gjitha rregulloret tregtare dhe doganore në fuqi. Ligje të ndryshme tregtare kombëtare dhe ndërkombëtare kufizojnë ose ndalojnë importin dhe eksportin e produkteve ose shërbimeve. Këto kufizime bazohen jo vetëm në natyrën e produktit, por edhe në vendin e origjinës ose të destinacionit dhe, ndonjëherë, edhe në identitetin e klientit dhe furnitorit (sanksionet).

13. PASTRIMI I PARAVE

- Jini vigjilentë dhe raportoni menjëherë tek eprori juaj ose departamenti i kontrollit çdo transaksion financiar të dyshimtë.

Sika është e angazhuar të mbështesë luftën kundër pastrimit të parave. Pastrimi i parave nënkupton përfshirjen në ciklin e rregullt financiar dhe ekonomik të aseteve (jo vetëm para në dorë) që vijnë nga veprimtari kriminale. Pastrimi i parave është krim.

RREGULLAT E ZBATIMIT

14. SIGURONI PAJTUESHMËRINË ME KËTË KOD

- Ky Kod Sjelljeje zbatohet për të gjithë punonjësit e Sika. Të gjithë punonjësit që i bashkohen Sika-s janë të lutur të përkushtohen ndaj këtyre rregullave dhe të informohen për rëndësinë e tyre.
- Të gjithë punonjësit në të gjitha kompanitë do të kujtohen rregullisht, të paktën një herë në vit, për këto rregulla.
- Menaxherët e përgjithshëm të të gjitha kompanive të Sika-s çdo vit do të konfirmojnë pajtueshmërinë e kompanisë së tyre me këto rregulla.
- Funksionet e Korporatës do të kryejnë trajnime dhe auditime të rregullta.

Ndërkohë që Korporata do të sigurojë instrumentet dhe metodat e nevojshme, me këtë Kod Sjelljeje është një përgjegjësi e vazhdueshme e drejtuesve të linjës. Përzgjedhja, trajnimi dhe mbikëqyrja e duhur e personelit është gjithashtu vendimtare në këtë aspekt.

15. MBANI TRANSPARENCË TË PLOTË DHE RAPORTONI

- Deklaroni dhe llogarisni siç duhet çdo transaksion.
- Informoni eprorin tuaj për konflikte të mundshme me këto rregulla.
- Raportoni shkeljet e këtyre rregullave tek eprori juaj, te BNj ose te një nga drejtuesit tuaj lokal, ose nëse nuk është efektive ose e realizueshme, komunikoni me një nivel më të lartë drejtues. Ju gjithashtu mund të komunikoni me Departamentin e Pajtueshmërisë së Korporatës përmes adresës së emali-t (compliance@ch.sika.com) ose përmes Linjës së Besimit të Sika-s (<https://sikatrulstline.com>).
- Personat që raportojnë me mirëbesim do të mbrohen nga hakmarrja. Shkelësit e këtyre rregullave do të përballen me masa disiplinore.

Në Sika, ne përkrahim një klimë të hapur dhe plotësisht transparente. Transparenca në lidhje me konfliktet e mundshme dhe shkeljet e zbuluara ndihmon në zbatimin e këtij Kodi Sjelljeje. Transparenca është gjithashtu e rëndësishme në lidhje me dokumentimin e saktë dhe kontabilizimin e të gjitha transaksioneve. Ne inkurajojmë të gjithë punonjësit të raportojnë dhe të informojnë siç duhet dhe në kohë eprorin e tyre, Departamentin

*lokal të BNj ose çdo anëtar tjetër të ekipit lokal të menaxhimit në lidhje me incidentet kritike, sipas parimeve të përcaktuara në **Politikën e Mirëbesimit të Sika-s** (Sika Trust Policy). Shkeljet e supozuara do të hetohen me kujdes dhe, nëse konfirmohen, do të kenë pasoja disiplinore për personat e përfshirë (duke përfshirë shkarkimin nga puna aty ku është e zbatueshme), ndërsa personat raportues do të mbrohen nga hakmarrja në rastet kur raportojnë në mirëbesim dhe për arsye të bazuara.*

16. BËHUNI SHEBULL PËR TË TJERËT

- Si epror, bëhuni shembull për të tjerët dhe respektoni rreptësisht Kodin e Sjelljes.
- Aplikoni një politikë tolerancë zero në fushën tuaj të përgjegjësisë.
- Këmbëngulni për transparencë në mënyrë që të trajtoni rreziqet e mundshme që në fazë të hershme.

Dhënia e rëndësisë së duhur që nga pozicionet drejtuese më të larta është një element thelbësor për t'i dhënë jetë këtij Kodi Sjelljeje. Është shumë e rëndësishme të bëheni shembull i mirë për të tjerët dhe të zbatoni një politikë të tolerancës zero. Kjo do të thotë gjithashtu të keni një mjedis pune ku konfliktet e mundshme trajtohen hapur dhe në mënyrë konstruktive.



17. MOS I ANASHKALONI KËTO RREGULLA

- Mos përdorni palë të treta për të anashkaluar këto rregulla.

Sjellja kritike ose praktika e biznesit nuk duhet t'u delegohen palëve të treta (p.sh., agjentëve, shpërndarësve, konsulentëve) për të anashkaluar këto rregulla.

18. PYETNI NËSE KENI DYSHIME

- Gjithmonë pyesni nëse jeni në dyshim.

Në shumë raste, shkeljet e ligjeve ose udhëzimeve të brendshme mund të shmangen nëse merrni këshilla në kohën e duhur. Nëse jeni në dyshim se çfarë vendimi ose veprimi duhet të ndërmerri, pyetni të tjerët fillimisht dhe kërkoni këshilla ose ndihmë nga menaxheri ose departamenti/funksioni përkatës (p.sh., Departamenti i BNj, Ligjor, Pajtueshmërisë ose Financës).

19. RREGULLI I PËRGJITHSHËM: RREGULLI I GAZETËS

- Aty ku nuk ka një rregull specifik ose nëse jeni në dyshim, kontrolloni sjelljen tuaj me rregullin e thjeshtë të gazetës: A do të vepronit njëloj nëse kjo do të shfaqej në faqen e parë të gazetës suaj lokale me të gjitha detajet?

Edhe pse shumë nga këto rregulla mund të jenë specifike dhe mund të mos mbulojnë rastin aktual, rregulli i gazetës kuptohet dhe zbatohet globalisht. Ai siguron një test të shëndoshë nëse një sjellje e caktuar është e lejuar apo jo.

20. ZBATONI PARIMIN “ME DY PALË SY”

- Të gjitha angazhimet në emër të Sika-s, pavarësisht nëse janë bërë në letër apo në mënyrë digjitale, duhet të nënshkruhen nga dy persona të autorizuar, edhe nëse ligji vendas lejon vetëm një palë nënshkruese.

- Nëse angazhimi bëhet me komunikim elektronik (email, mesazh me tekst, etj.), vetëm një person mund ta nënshkruajë atë. Megjithatë, një person i dytë duhet të shqyrtojë dhe miratojë angazhimin përpara se të dërgohet.
- Nëse nuk kërkohet nga ligji vendas, mos përdorni kurrë vula ose pulla personale; nëse përdorni vula/pulla, shtoni gjithmonë nënshkrimin tuaj personal.

Parimi “me dy palë sy” është parimi kryesor i Sika-s për menaxhimin e duhur të rrezikut dhe sjelljen etike. Çështjet e biznesit duhet të rishikohen nga një person i dytë dhe të sigurohet një proces vendimmarrjeje vigjilent dhe në mënyrë të veçantë pajtueshmëria me këtë Kod Sjelljeje.

21. PYETJE / KOMENTE

Nëse jeni në dyshim ose keni pyetje në lidhje me këtë Kod Sjelljeje, kontaktoni eprorin ose Korporatën tuaj. Ju gjithashtu mund të dërgoni pyetjet dhe komentet tuaja në adresën compliance@ch.sika.com.





KODI I SJELLJES

INTEGRITETI DHE SJELLJA ETIKE

BUILDING TRUST

